

FJALA E DEPUTETIT DAMIAN GJIKNURI

E ENJTE 24 MARS 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë dhe qytetarë që na dëgjoni,

Në fakt, ky mocion për debat natyrshëm ka vëmendje për publikun shqiptar, për arsye se të gjithë po përjetojnë një moment të vështirë për rrethana dhe shkaqe që i dimë të gjithë, të cilat nuk varen vetëm nga vendi ynë. Nga ana tjetër, këtu politikisht po promovohen edhe filozofitë e flukseve politike që po përjeton opozita. Në njërin krah është një ekip që thotë: “Ç’më duhet mua se ç’ndodh përreth”, apo e thënë ndryshe “kur humbet dhe fiton”, në kahun tjetër është ekipi tjetër: “Korbat dhe vdekja”. E filloi me trupat, kur tha: “2000 trupa”, a thua se po flet për luftërat që i ka në kokën e vet, dhe pastaj vazhdoi me gjithë politikën e “vdekjes” dhe tragjedinë që do t’u injektojë shqiptarëve në mendje për të dalë aty ku doli në fund, që tha: “Të ngrihen shqiptarët”. Pa dashje nxori se ka qenë edhe furnitori politik, mbase edhe me njerëz, i protestave.

Natyrisht, mund të ketë edhe njerëz që janë të shqetësuar për çmimet, por kur njerëzit manipulohen politikisht dhe u injektohet gjuha e urrejtjes, duke shkaktuar shkëputjen nga realiteti për të mos njohur shkaqet e vërteta të gjendjes dhe çfarë presim nga qeveria, kjo është të mos ta duash këtë vend; kjo është t’i vësh zjarrin këtij vendi, duke përfituar nga momenti i vështirë. Të gjithë e dimë se për shkak të krizave që kanë ardhur këta dy vjet kanë qenë të vështira dhe efekti ekonomik postpandemi ka ndikuar, sikurse ishte inflacioni, por edhe kriza politike me luftën ruso – ukrainase ka dhënë impakt në të gjithë botën. Këto janë vende që kanë një sërë produktesh që ndikojnë direkt në ekonominë e vendeve, sikurse janë drithërat dhe shumë prodhime që lidhen me bujqësinë, po ashtu edhe produktet energjetike, si nafta dhe gazi. Të mos bëjmë naivin këtu, prandaj e quajta shkëputje nga realiteti, se e dimë shumë mirë se efekti që ka impaktuar të gjithë botën do të vinte edhe në Shqipëri.

Qeveria nuk ka faj për ngjarje, që as i parashikon dhe as nuk i kontrollon dot. Gjithçka që presin njerëzit, edhe ne këtu duhet ta drejtojmë debatin, është të dimë se çfarë po bën qeveria. Qeveria po bën atë që ka mundësi, brenda mundësive të saj ekonomike, pa destabilizuar shtetin, pa shkëputur shërbimet esenciale, po përdor financat publike për t’u ardhur në ndihmë qytetarëve dhe për të zbutur krizën. A po e zbut sa duhet? Hajdeni ta debatojmë këtë. A po i përdor të gjitha nevojat dhe mundësitë financiare? Them se po, por ejani t’i shikojmë edhe mundësitë financiare të qeverisë. Këtu u përmend energjia, dihet që çmimi është rritur se këtu thuhet: uji, uji, uji. Vërtet në Shqipëri prodhohet, ka sasi prodhimi në vite të caktuara, por prodhimi ynë nuk i mbulon 12 muajt e vitit me sasi të që kemi nevojë. Ne prodhojmë atëherë kur energjia është më e lirë dhe kur ka reshje. Ky është problemi i mungesës së diversifikimit të prodhimit të energjisë, prandaj po bëhen hapa, që patjetër duan kohë. Por të mos harrojmë sesi e latë ju sektorin energjetik, që nuk dua t’i kthehem, por ti vetë le një “kufomë energjetike”, pavarësisht se e prezantoje si superfuqi energjetike.

Janë bërë shumë gjëra në këto vite dhe energjia ka vajtur në pikën që nuk mungon furnizimi me energji elektrike. Kjo falë investimeve dhe menaxhimit. Nga ana tjetër, qeveria e ka marrë një risk, për të cilin mbase edhe unë nuk do të isha dakord, sepse reformat në energji gjithmonë kanë synuar që tregu të liberalizohet. Unë kam qenë promotor i tyre kur isha ministër, me idenë që një pjesë e kostove të shkarkohet sipas tregut të biznesi dhe të përdoruesit privatë. Në fakt, qeveria këtu ka marrë një risk të madh, pasi mund të shkojë 400-500 milionë euro fatura e energjisë. Me këto taksa që ju kërkoni të ulen, si taksa e naftës, do të mbushet buxheti i shtetit për të përballuar faturën e energjisë. Sado lirë ta prodhojmë në energjinë, siç tha zotëria parafolës, nuk është vetëm çështja e prodhimit, sepse ka transmetim, shpërndarje, investime, stok borxhesh prej qindra milionësh, të trashëguar nga qeveria e zotërisë në fjalë, të gjitha këto janë pjesë e strukturës së çmimit. Çfarë ka bërë qeveria?

Qeveria ka ndjekur interesin publik, kundër parimeve të tregut, ka mbrojtur konsumatorët familjarë, ka mbrojtur biznesin e vogël. Madje, për mendimin tim ka shkuar edhe më tej, ka arritur të mbrojmë edhe biznesin e madh, që u tha pak më parë këtu, që duhet ekspozuar me çmimet e tregut. Përse e ka bërë këtë? për të mbrojtur prodhimin? Për të mbrojtur të gjitha strukturat e prodhimit, sepse çmimi i energjisë do të kishte vajtur në atë pikë, sa do të falimentonte të gjitha bizneset. Ku do të ishim pastaj? Nuk do të kishim as prodhim, as të ardhura për buxhetin e shtetit, do të kishte një papunësi masive, por, mbi të gjitha Shqipëria, do të humbte kapacitetet e saj prodhuese. Prandaj për mendimin tim masat e qeverisë janë shumë ekstreme në dobi të qytetarëve dhe janë mirëfilltazi masa sociale. Të harxhosh 500 milionë euro mbështetje për energji, kush e ka bërë këtë? As në kohën tuaj nuk është bërë kurrë. Kjo është bërë vetëm e vetëm për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve dhe për këtë duhet të na kuptojnë. Pikërisht, një pjesë e atyre taksave të hidrokarbureve shkojnë për të mbushur buxhetin dhe për të përballuar këtë faturë.

Nga ana tjetër, qeveria po adreson njerëzit që janë më në nevojë, sepse këto janë mundësitë, qoftë për ngritjen e çmimit të drithërave, qoftë për shportën bazë dhe për konsumin tjetër, që të gjithë qytetarët e përballojnë me vështirësi. Kush po ndihmohet? Po ndihmohen pensionistët, njerëzit në nevojë dhe shtresat më të prekura. Kjo sa ka filluar, ju e thatë vetë, e the edhe pak më parë, se edhe lexon, përmend institute. Ti e di shumë mirë, meqë lexon, që thuhet se përgatitet një krizë e vështirë për drithërat dhe për furnizimin. Nëse ka një problem postpandemik në ekonomi, është prishja e sistemit të furnizimeve, sidomos për sa u përket produkteve ushqimore, ku parashikohet të ketë rritje të çmimeve. Atëherë, çfarë duhet të bëjë qeveria, t'i luajë të gjitha kartat përnjëherë? Qeveria po bën gjithçka dhe po e monitoron krizën. Kryeministri ka thënë se këto masa janë për tre muajt e parë. Ne nuk e dimë se çfarë sjell lufta, por edhe pasojat e luftës asnjë nuk e di. Kush mund ta parashikojë të ardhmen? Doli parlamenti shqiptar dhe po i jep të gjitha zgjidhjet?! NATO-ja është mbledhur 3-4 herë qoftë për aspektin e sigurisë, qoftë për impaktin, sepse kanë dalë të gjithë kokat dhe po "kruajnë kokat", duke menduar se si do t'i përballojnë pasojat e kësaj krize.

Të gjitha zgjidhjet do t'i gjeni nga Edi Rama ju?! Bëhuni realistë, sepse kjo qeveri po e monitoron situatën. Këto ka në dorë. Edhe ato borde për kontrollin e çmimit, vërtet duken pak të rrepta, jo normale për kushtet e tregut, por diktohen nga kriza. Periudhat dëshpëruese kërkojnë masa të rrepta dhe qytetarët shqiptarë na mirëkuptojnë në këtë drejtim. Këtu u qahet halli tregtarëve. Edhe tregtarët e karburanteve do të marrin koston e tyre. E përmendi një deputet nga krahu juaj, që i njez hidrokarburet,

ku tha që tregtarët e karburanteve po tregtojnë me humbje. Kjo mund të jetë e vërtetë, se këto janë çmimet, por kjo do të thotë se qeveria ua ka ngarkuar një pjesë të barrës edhe atyre. Edhe ata nuk mund ta mbajnë barrën gjatë gjithë kohës, se është rrezik pjesa e furnizimit më vonë, por një pjesë të saj duhet ta mbajnë. Po çfarë mase është kjo? Masë sociale, masë në dobi të oligarkëve, apo masë në dobi të njerëzve që kanë aksione në energji, siç u tha këtu? Jo, është e kundërta. Pra, ata kanë marrë një pjesë të riskut, ashtu siç po e merr edhe shteti shqiptar. Ky është një proces që sapo ka filluar, nuk e dimë se sa do të shkojë. Nuk dua të përhap panik për qytetarët shqiptarë, por një qeveri e përgjegjshme monitoron situatën dhe nuk i hedh të gjitha kartat menjëherë në zbatim.

Ne, natyrshëm, do ta monitorojmë situatën, patjetër rritja e çmimeve mund të ketë ndikim në shumë sektorë të tjerë. Vërtet mund të thotë dikush që u rritën të ardhurat nga taksat, sepse janë rritur çmimet, por mund të zvogëlohet puna publike, sepse disa kantiere mund të mos punojnë më, kostot e ndërtimit janë rritur. Procese të tjera mund të ndërpriten, mund të kemi distraction të tregjeve. Kjo do të thotë që potencialisht mund të kemi të ardhura më të ulëta në buxhetin e shtetit. Pra, nuk e dimë si do të shkojë kjo gjë. Çfarë duhet të bëjë qeveria? Të heqë të gjitha taksat e pastaj të ngrejë duart lart? Ju dëshironi të përmbushet skenari: o burra, o popull, nuk kemi bukë të hamë dhe hajde dilni të përmbysim qeverinë. Po përse, me “politikën e korbave” do të vini në pushtet ju?! Ti nuk vjen, por edhe këta të tjerët, këta që pretendojnë të vijnë. Përse këtë doni, tokë të djegur, që të vini në pushtet? Të dalim te pjesa që populli duhet të dalë në protestë se nuk ka më bukë, të përmbysët qeveria dhe ta merrni ju. Të shkojë ai si “gjeli mbi pleh” e të thotë: “Ja si e gjeta situatë dhe do ta shpëtoj unë”. Jo, kjo është papërgjegjshmëri.

Njerëzit janë të stresuar, janë të lodhur, qytetarët shqiptarë kanë nevojë për mbështetje, por kanë nevojë edhe për komfort psikologjik. Qeveria po bën gjithçka dhe të gjithë duhet të jemi në mbështetje, me mundësitë që kemi, për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve në këtë situatë, por pa prishur elementet bazë që mbajnë këtë shtet. Ndryshe, ajo “pranverë” që ti u thua shqiptarëve, do të kthehet në një “pranverë kobzezë”, që vetëm ti, në mendjen tënde e imagjinon. Ne nuk jemi për këtë, prandaj na falni shumë! Faleminderit!